



**Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit /
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije / Ministry of Education, Science,
Technology and Innovation
Departamentit i Arsimit Parauniversitar
Divizioni Arsimit gjithëpërfshirës**

Në mbështetje të nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 14 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023), dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka hapur:

Thirrje publike për nominim

Për anëtar/e student/e të Këshillit Shtetëror të Cilësisë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim

1. Një (1) anëtar/e student/e.
2. Kohëzgjatja e angazhimit: Anëtari/ja zgjidhet për një mandat dy (2) vjeçar.

Kriteret dhe Papajtueshmëria;

1. Kandidatët për anëtarë/e student/e të KShC-së duhet t'i plotësojnë kriteret në vijim:

- 1.1. Të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
- 1.2. Të kenë njohuri të konsiderueshme për funksionimin e arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë në Kosovë e cila dëshmohet përmes angazhimit apo pjesëmarrjes në aktivitete, projekte, pozita relevante;
- 1.3. Të kenë njohuri, përvojë të konsiderueshme për funksionimin e zonës evropiane të arsimit të lartë dhe standardeve ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë;
- 1.4. Të jetë së paku në nivel të studimeve Master ose Doktoratë në IAL-të e Kosovës.
- 1.5. Njohja e gjuhës angleze e detyrueshme.

Papajtueshmëria për të qenë anëtar/e student/e i/e KShC-së

2. Anëtar/e i/e KShC-së nuk mund të jetë personi që:

- 2.1. Ka ushtruar post politik në Kosovë në tri (3) vitet e fundit;

- 2.2. *Ka qenë themelues, bashkëthemelues, aksionar dhe anëtar i Këshillit Drejtues në Institucione të Arsimit të Lartë në pesë (5) vitet e fundit;*
- 2.3. *Ka angazhim aktual në më shumë se një institucion të arsimit të lartë në Kosovë dhe jashtë Kosovës;*
- 2.4. *Është dënuar nga Gjykata me vendim të formës së prerë për vepër penale të dënueshme me burgim më shumë se gjashtë (6) muaj sipas Kodit Penal të Republikës së Kosovës;*
- 2.5. *Konstatohet se ka konflikt interesi sipas legjislacionit në fuqi.*

Kompensimi;

Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Shtetëror të Cilësisë bëhet sipas legjislacionit në fuqi që rregullon fushën përkatëse.

Procedura e konkurrimit;

Kandidatët duhet të dorëzojnë këto dokumente:

- *Dokumentin Identifikimi (kopje të dokumentit identifikues, pasaportës, letërnjoftimit apo certifikatës së shtetësisë, e cila duhet të jetë valide).*
- *Certifikatën mbi gjendjen penale të lëshuar nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, se nuk ka dënime penale në evidencën qendrore penale të Republikës së Kosovës (certifikata e nxjerrë online në platformën e-Kosova do të pranohen);*
- *Dokument valid që dëshmon statusin e studentit në studimet Master ose Doktoraturë;*
- *Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI ose të këtë dëshmi që është në proces të nostrifikimit);*

Vlerësimi i të nominuarve për anëtar/e student/e i/e KShC-së;

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit themelon Komisionin e përkohshëm për shqyrtimin e aplikimeve për anëtarë student/e të KShC-së, bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr.08/L-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (Gazeta Zyrtare Nr.13/29 qershor 2023)

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet duke i dërguar dokumentet në E-Mail: info.mashti@rks-gov.net, me përshkrimin në Subjekt: Aplikim për anëtar/e student/e të KShC-së.

Të gjithë kandidatët e interesuar mund të aplikojnë **nga data 29.06.2024 deri me 13.07.2024.**

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit inkurajon të gjithë të interesuarit dhe mirëpret aplikimet e secilit kandidatë/e për t'u bërë pjesë e **Këshillit Shtetëror të Cilësisë** në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA).